

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-176/2015

Prishtinë
18 prill 2018

Në çështjen juridike të:

M. D.

E përfaqësuar nga:

I.O. (avokat)

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014, të datës 30 prill 2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA21380), pas shqyrtimit të mbajtur më 18 prill 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga Z. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014, të datës 30 prill 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA21380.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014, i datës 30 prill 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numrin KPA21380.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 20 prill 2007, M. D. (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) ku kërkonte ri-posedim ndaj një pjese të ngastrës kadastrale nr. 857/2, e klasifikuar si pyll me sipërfaqe prej 03.38.00 ha, që gjendet në fshatin Dresnik, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejshëm: pronë e kërkuar). Ajo kishte deklaruar se ajo ishte pronare e vetme e pronës që ajo e kishte fituar mbi bazën e vendimit të Komunës së Klinës. Sipas palës ankuese, pronë e kërkuar është e uzurpuar nga një person i panjohur. Humbja e posedimit mbi pronën ishte rezultat i rrethanave që kishin ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998/1999. Si datë të humbjes ajo e kishte cekur datën 17 qershor 1999.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, pala ankuese kishte dorëzuar në AKP kopjen e Vendimit nr. 04-463-54/92-2, të lëshuar më 5 mars 1997 nga Kuvendi Komunal i Klinës, Departamenti për Urbanizëm, Çështje Komunale dhe Banesore dhe Pronë, me të cilin kërkesa e palës ankuese ishte miratuar dhe përmes të cilit ishte prishur Aktvendimi i plotfuqishëm nr. 215, i datës 1 dhjetor 1963, i lëshuar nga Komisioni i Dytë Komunal për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësore që dalin nga uzurpimi arbitrar i tokës shoqërore. Gjithashtu, ishte vërtetuar se pala ankuese ishte pronare e pronës së kërkuar; prandaj, Zyra e Kadastrës në Klinë ishte e obliguar ta regjistronte pronën e kërkuar në emër të palës ankuese. Vendimi ishte bërë i plotfuqishëm më 8 prill 1997.
3. Njoftimi i kërkesës ishte bërë më 17 qershor 2010 duke e publikuar atë në Gazetën Njoftuese të AKP-së nr. 2 dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës së UNHCR-it. Gazeta dhe Lista ishin lënë te kryetari i fshatit, i cili kishte pranuar t'i vinte ato në dispozicion për palët e interesuara. Publikimet e njëjta ishin lënë në Komunën e Klinës, Zyrën e Kadastrës dhe në Gjykatën Komunale të Klinës, zyrën rajonale të AKP-së në Pejë. Gjithashtu, Lista dhe Gazeta ishin shpërndarë në UNHCR, Ombudsperson, Komitetin Danez për Refugjatë (DRC), Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
4. Vendimi nr. 04-463-54/92-2 nuk ishte gjetur në institucionet kompetente në Kosovë dhe as në organet e zhvendosura, ndërsa pronë e kërkuar ishte gjetur se ishte pronë shoqërore e regjistruar në emër të NSH "Ekonomia e Pyjeve".
5. Më 30 prill 2014, KKKPK-ja në vendimin e saj KPCC/D/A/236/2014, e kishte hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese me arsyetimin se ajo nuk e kishte dëshmuar se kërkesa përfshinte rrethanat që drejtpërdrejte ndërlidheshin apo rezultonin nga konflikti i viteve 1998-1999. Për këtë arsye, sipas Komisionit, kërkesa binte jashtë juridiksionit të saj dhe kështu ajo duhej hedhur poshtë.

6. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 24 nëntor 2014, ndërsa Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte pranuar ankesën më 24 dhjetor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

7. Pala ankuese e kundërshtoi vendimin e KKPK-së mbi bazën e shkeljes thelbësore të së drejtës materiale dhe procedurale si dhe mbi bazën e vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike.
8. Sipas palës ankuese, AKP-ja kishte lëshuar vendimin e saj pa analizuar dhe shqyrtuar provat e bashkangjitura me kërkesë, sepse pala ankuese është pronare e pronës së kërkuar mbi bazën e Vendimit nr. 04-463-54/92-2, i cili ishte bërë i plotfuqishëm më 8 prill 1997. Pala ankuese kishte deklaruar se Drejtorati i Kadastrës ishte autorizuar për të kryer ndërrimet në Kadastrë, që donte të thoshte se nëse Kadastra nuk do e kryente punën e vet kjo nuk mund të ndikonte negativisht në të drejtat e saj mbi pronën e kërkuar.
9. Në fund, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës të miratoj ankesën e saj si të bazuar dhe të njoh atë si pronare të pronës së kërkuar.

Pranueshmëria e ankesës

10. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh si në vijim: *“brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit për kërkesën, pala mund të parashtrij ankesë përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër një vendimi të tillë”.*
11. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 24 nëntor 2014, ndërsa Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e kishte pranuar ankesën më 14 janar 2015. Megjithatë, Gjykata Supreme kishte gjetur dëftesën e Postës së Kosovës që dëshmonte se pala ankuese e kishte dorëzuar ankesën më 24 dhjetor 2014.
12. Neni 127.2 i Ligjit nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008) parasheh si në vijim: *“në qoftë se parashtrësja është dërguar me anë të postës me letër rekomande apo në rrugë telegrafike, dita e dorëzimit në postë konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatën të cilës i është drejtuar.”*
13. Prandaj, ankesa është paraqitur brenda afatit 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

Arsyetimi ligjor

14. Pas shqyrtimit të dokumenteve në dosjen e lëndës, Gjykata Supreme është e mendimit se vlerësimi i KKPK-së kishte qenë i drejtë dhe se argumentat e ngritur nga pala ankuese nuk kanë mundur të qojnë në ndryshimin e vendimit.
15. Duke marrë parasysh dokumentacionin që përmban dosja e lëndës, i vetmi konstatim i vlefshëm për të drejtën pronësore/të posedimit të palës ankuese është se asnjëra nga provat nuk paraqet se pala ankuese kishte qenë në posedim të pronës së kërkuar para apo gjatë konfliktit dhe se humbja e posedimit ndaj saj kishte ndodhur për shkak të konfliktit.
16. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë verifikimin negativ të dokumentit, mbi të cilin pala ankuese e mbështet kërkesën e saj për pronësi. KKPK-ja nuk ka qenë në gjendje të siguroj *ex officio* asnjë provë tjetër që do të mbështeste pretendimet e palës ankuese.
17. Sipas nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike - Pronësore (GZ e RSFJ-së, nr.6/1980), i aplikueshëm në kohën kur ishte lëshuar Vendimi nr. 04-463-54/92-2, e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimnë bazë të

veprimet juridik (që është vendimi në këtë rast) e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në "librin publik " (Librin e Kadastrës) ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj (neni 33 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike – Pronësore, GZ e RSFJ-së, nr.6/1980).

18. Pala ankuese nuk pa dorëzuar asnjë dokument në lidhje me këtë. Në veçanti, ajo nuk e ka dëshmuar se Vendimi nr. 04-463-54/92-2 i Kuvendit Komunal të Klinës, i datës 5 mars 1997, të jetë ekzekutuar ndonjëherë, dhe se si pasojë e kësaj pala ankuese të ketë siguruar posedimin mbi pronën e kërkuar, e cila më pas ka mundur të humbej për shkak të konfliktit. Në fakt Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e kishte gjetur *ex officio* Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme që tregon se prona e kërkuar ishte e regjistruar si pronë shoqërore në emër të “Ekonomia e Pyjeve”. Kjo e shpiu gjykatën në konstatimin se pala ankuese nuk kishte mundur realisht të fitonte të drejtën pronësore, pasi që kërkesat e nenit 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko - Pronësore (RSFJ, nr. 6/1980) nuk ishin përmbushur.
19. Duke e marrë parasysh atë që u tha më lartë, Gjykata Supreme thekson se kërkesa bie jashtë juridiksionit të AKP-së. Fakti që prona e kërkuar në regjistrat kadastral paraqitet si pronë shoqërore përjashton mundësinë që AKP-ja të shqyrtoj rastin. Për këtë arsye kërkesa është dashur të hidhet poshtë dhe ankesa të refuzohet si e pabazuar.
20. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3(a) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it

Ragip Namani, gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, ushtrues detyre i referentit të EULEX-it